



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.498/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli kryesues, Hidajete Gashi Alaj, dhe Ramush Bardiqi ,anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV),me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, Anr.498/2025 e datës 09.02.2025, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datë 09.02.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.387/2025 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës në të cilën pretendohet se me datë 09 shkurt 2025, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, z. Asdren Gashi ka publikuar një fotografi në rrjetin social Facebook, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/h, me tekstin përshkruar "Sot është dita e demokracisë të vetëvendosim mes Kosovës sot të zhvilluar e me sovranitet, apo Kosovës dikur të lodhur e pa sovranitet! Unë vetëvendosja vendos edhe ti!", i cili në mënyrë indirekte ka bërë fushatë përmes thirrjes për të votuar subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Postimi i publikuar nga z. Asdren Gashi, në rrjetin social Facebook. Sipas parashtruesit të ankesës bërja e fushatës në çfarëdo mënyrë, pas hapjes së qendrave votimit, respektivisht pas ores 07:00/h, përbën shkelje të rregullave zgjedhore të përcaktuar në LZP dhe rregulloret përkatëse.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LVV theksohet se si Lëvizje Vetëvendosje vlerësojmë se ankesa e tillë është e pabazë për faktin se ankuesi në ankesën me nr.498, ka paraqitur fakte të cilat janë paraqitur në ankesën me nr.499/2025.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga subjekti politik LVV, vlerësoj se pretendimet e parashtruara në ankesë janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pa bazuara, kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së bërë nga ana e mbështetësit të subjektit politik LVV z.Asdren Gashi, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë si dhe nga verifikimet e bëra vlerësoi se ankesa Anr.498 është identike me ankesën 499/2025 dhe prova e ankesës 498 rezulton të jetë bashkangjitur me ankesën 499 për të cilën Paneli ka marr vendim A.nr.499/2025 të datës 11.02.2025.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.498/2025 më datë 12.02.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.